

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL
NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, GUSHT 2023**

1. Nxënësi/nxënësja* merr gjithsej **2 pikë** nëse ka shkruar: *Përpara se të ushtrohesh në programe fitnesi është e këshillueshme që të kryesh një vizitë mjekësore, përmes së cilës mjeku do të rekomandojë më pas se për cilat ushtrime je i aftë të kryesh. Trajneri personal luan një rol të dorës së parë te individët që dëshirojnë të ushtrohen.*

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje pjesërisht të saktë, nëse ka shkruar çfarë është e këshillueshme përpara se të ushtrosh ose rolin e trajnerit personal.

2. Është rrethuar numri 2: *48 orë – 1 pikë*

3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Përveç këtyre programeve me komponentë esenciale, ushtrimet bazohen edhe në programe individuale të fokusuara në aftësitë specifike, moshën e individit ose në nevojat për një shëndet të mirë.*

4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *U shtohen shpesh edhe fuqia e shpejtësia.*

5. Gjithsej **1 pikë** nëse ka shkruar: *Nëse nuk mund të shkosh në një palestër, ose nuk mund të përballosh për të marrë një shumë apo çmim të caktuar, atëherë mund të bësh "fitnes shtëpiak" edhe me një shtangë dore dhe një stol.*

6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Martin Camaj*

7. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Jera paraqitet në gjendje të mundimshme shpirtërore dhe nuk dëshiron të besojë se i ka ndodhur diçka e keqe Dakut etj.*

8. Gjithsej **2 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 1: *fati tragjik i Dakut*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse e argumenton përgjigjen me pjesë nga teksti: *Tregohej se kishin pasë gjete trunat e ujqeve të shkyem; lehej në heshtje fati i Dakut ose shtegtari i Përtejqqafës e këpuste kuvendin me një shej mospërfillje se nuk dashkej ta zaje në gojë atë ngjarje aq të dhimbshme.*

9. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *ortek dëbore, dheu e gurësh.*

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *gjinia dramatike*

11. Është rrethuar numri 1: *marrëdhëniet emocionale ndërmjet Vladimirit dhe Estragonit*
– **1 pikë**

12. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *dialogu*.

13. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Paraqitet në mënyrë qesharake se si përpiqen të ndihmojnë njëri -tjetrin duke u ndjerë të raskapitur etj.*

14. Gjithsej **3 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 4: *Vladimiri*

B) Nxënësi merr **2 pikë** nëse e argumenton përgjigjen: *“Rastinjaku dhe Zonja Voker” janë personazhe të romanit “Xha Gorio”, Mërsoi personazhi i romanit “I huaji”, kurse Vladimiri është personazh i fragmentit “Duke pritur Godonë”.*

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të pjesshme.

15. Gjithsej **2 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar ose rrethuar: *konfliktin*.

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar ose rrethuar: *autorit*.

16. Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar: 1. *Lufta për mbrojtjen e trojeve nga të huajt*
2. *Lufta për mbrojtjen e nderit e të dinjitetit personal e familjar.*

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të pjesshme, nëse ka shkruar njërën temë.

17. Gjithsej **3 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *sonet*.

B) Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar: *Këto vargje i kushtohen vashës me emrin Laura që e njohu në rini dhe ka vdekur e re; vegimi i saj i shfaqet poetit në vetminë e natyrës dhe ai nis e bisedon me të sikur të ishte ajo pranë tij etj.*

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të pjesshme, nëse tregon kujt i kushtohen këto vargje ose çfarë i shfaqet poetit në vetminë e natyrës.

18. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: kur t' ngjau se i mbylla, i çela n' dritë t' amshueme.

19. Është rrethuar numri 1: e alternuar (ab / ab) – **1 pikë**

20. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: 1. sy të mprehtë, 2. mendje të mprehta, 3. vlera të vërteta.

21. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: me ndajfolje

22. Është rrethuar numri 1: vendore – **1 pikë**

23. Gjithsej **2 pikë** nëse ka shkruar saktë të gjitha shenjat e pikësimit: Ai dukej sikur qeshte (,) ndoshta për shkak të hijeve që i binin mbi fytyrë(.) Prita (.) Nxehtësia e diellit po më përvëlonte faqet dhe ndjeva bulëza djerse të më grumbulloheshin mbi vetulla(.) Dielli ishte si atë ditë kur varrosa mamanë dhe si atëherë (,) balli më e të gjitha venat rrihnin fort nën lëkurë (.)

Nxënësi merr **1 pikë** për pesë shenja të pikësimit të shkruara saktë.

24. Skema e vlerësimit të tekstit funksional

FORMA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT <i>3 pikë</i>	GJUHA <i>3 pikë</i>	STILI <i>2 pikë</i>
Të gjitha të dhënat e shkruara në udhëzim janë renditur sipas parimeve të hartimit të tekstit. <i>3 pikë</i>	Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. <i>3 pikë</i>	Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i>
Të gjitha të dhënat janë renditur mirë, por mungon ndonjë e dhënë që e vështirëson kuptimin e tekstit, përkatësisht elementi kryesor që nuk e përmbys formën e tekstit. <i>2 pikë</i>	Norma drejtshkrimore dhe gramatikore pjesërisht është respektuar, por ka lëshime si: - përdorimi i shenjave të pikësimit - përdorimi i drejtë i pjesëve gramatikore <i>2 pikë</i>	Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave.
	Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht: - nuk përdoret si duhet	

<p>Mungojnë shumë të dhëna, por teksti kuptohet. <i>1 pikë</i></p> <p>Nuk është respektuar forma e dhënë ose përmbajtja e tekstit është e pakuptueshme. <i>0 pikë</i></p>	<p>gjuha letrare, por e folura dialektore</p> <p>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura dhe/apo)</p> <p>- gabon në përdorimin e parafjalëve... <i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>, gabon në përdorimin e trajtës mohuese. <i>0 pikë</i></p>	<p><i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>
---	---	--

25. Skema e vlerësimit të esesë: Dashuria, simbol me vlerë universale në veprën "Romeo dhe Zhulieta"

Përmbajtja 7 pikë

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruaj emrin dhe mbiemrin e autorit, llojin letrar dhe periudhën historike në të cilën është shkruar ajo (<i>1 pikë</i>) - shkruan se çfarë lajmëron kënga e laureshës dhe sa e vështirë është ndarja për ata. (<i>1 pikë</i>)
--	--

	<p>- shkruan për gjendjen emocionale psikologjike të Romes dhe Zhulietës (1 pikë)</p> <p><i>Gjithsej 3 pikë</i></p>
<p>Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë...</p>	<p>Krijimi i tekstit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qasja origjinale/ kreative ndaj temës (1 pikë) - përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë) <p><i>Gjithsej 4 pikë</i></p>

Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë

GJUHA 3 pikë	STILI 2 pikë	FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë
<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. <i>3 pikë</i></p> <p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore <p><i>2 pikë</i></p> <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të 	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i></p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. <i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë</p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi) <i>2 pikë</i></p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). <i>0 pikë</i></p>

<p>nënrenditura dhe/apo - gabon në përdorimin e parafjalëve... <i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j, gabon në përdorimin e trajtës mohuese. <i>0 pikë</i></p>	<p>të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>	
---	--	--

Skema e vlerësimit të esesë:

Empatia: Të vendosësh veten në këpucët e tjetrit

Përmbajtja 7 pikë

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna: - shkruan për konceptin e empatisë dhe rëndësinë e saj në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe kuptimplote (<i>1 pikë</i>) - shkruan për rolin e empatisë në barazinë shoqërore dhe për sfidën e paragjytimeve (<i>1 pikë</i>) - shkruan se si mund të ndihmojë zhvillimi i empatisë ndaj të tjerëve për të kultivuar inteligjencën emocionale dhe për të çuar drejt një komunikimi dhe bashkëpunimi efektiv me të tjerët (<i>1 pikë</i>) <i>Gjithsej 3 pikë</i></p>
<p>Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi</p>	<p>Krijimi i tekstit: - qasja origjinale/ kreative ndaj temës (<i>1 pikë</i>)</p>

dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë...	<ul style="list-style-type: none"> - përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë) <p>Gjithsej 4 pikë</p>
--	--

Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë

GJUHA 3 pikë	STILI 2 pikë	FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë
<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. 3 pikë</p> <p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore <p>2 pikë</p> <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <p>dhe/apo</p> <ul style="list-style-type: none"> - gabon në përdorimin e parafjalëve... <p>1 pikë</p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. 2 pikë</p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. 1 pikë</p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... 0 pikë</p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi) 2 pikë</p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). 0 pikë</p>

Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.

0 pikë